



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 6 datë 30/04/2014

**PËR**

**“PËRCAKTIMIN E VLERËS MINIMALE E MAKSIMALE TË QIRASË SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE DHE TË VLERËS MINIMALE E MAKSIMALE TË TË ARDHURAVE PËR PËRFITUESIT E BANESAVE SOCIALE ME QIRA, NË KUADËR TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I BANESAVE ME QËLLIM SOCIAL” NË ZONËN E SHKOZËS, ISH FONDER. MEK”.**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/I, shkronja “g”, nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 3, pika 1, shkronja “a”, nenit 6, nenit 11 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar); pikave 1, 2, 4, 5, 7 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 24.2.2010 për “Metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i Bashkive apo nga kombinimi i të dyjave”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 08.11.2005 për “Miratimin e Komisionit të Strehimit” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 11.04.2008 “Për miratimin e marrëveshjes së nënhuasë ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Financave për kreditë e marrë nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) për projektin “Ndërtimi i banesave për qëllim social”; urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë nr. 3189, datë 30.11.2012 mbi “Procedurat të cilat duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga programi i banesave sociale me qira”; urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë nr. 8464/1, datë 03.09.2013 mbi “Ngritjen dhe funksionimin e grupit paraseleksionues për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesve, që do të përcillen në Komisionin e Strehimit, për përfitimin nga program i banesave sociale me qira në kuadër të projektit të banesave sociale në zonën e ish “Fonderia Mek, Shkozë”; manualit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për “Menaxhimin e Banesave Sociale me Qira”, ju paraqesim për shqyrtim materialin e mëposhtëm:

**V E N D O S I:**

**1. Të miratojë vlerat minimale dhe maksimale të qirasë sipas strukturave të apartamenteve, si më**

poshtë:

<b>Struktura e apartamentit</b>	<b>G</b> (Q.min – Q.max)	<b>1+1</b> (Q.min – Q.max)	<b>2+1</b> (Q.min – Q.max)	<b>3+1</b> (Q.min – Q.max)
<b>Niveli i qirase</b>	3,920-7,840 lek	6,790 -13,580 lek	7,840 - 15,680 lek	9,310 - 18,620 lek

2. Të miratojë vlerat minimale dhe maksimale të të ardhurave sipas strukturave të familjeve, si më poshtë:

	<b>G</b> (1-2 persona)	<b>1+1</b> (3 persona)	<b>2+1</b> (4 persona)	<b>3+1</b> (5-6 persona)
<sup>3/1</sup> <b>Kategoria 1 (maksimale)</b>	31,360 – 44,447 L	54,320- 57,520 L	62,720- 70,592 L	74,480- 96,738 L
<b>Kategoria 2 (mesatare)</b>	15,680- 31,360 L	27,160 - 54320L	31,360 – 62,720L	37,240 – 74,480L
<b>Kategoria 3 (minimale)</b>	<sup>3/1</sup> 7,841 – 15.680 L	13,581-27,160 L	15,681 – 31,360 L	18,621 – 32,240 L
	<sup>3/2</sup> 3,921 – 17,250 L	6,791-29,900 L	7,841 – 35,500 L	8,000 – 41,000 L

Rrjeshti i parë i kategorisë 3 të të ardhurave i referohet nivelit minimal të të ardhurave të familjeve të përcaktuara në nenin 24, pika 2, të ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar).

<sup>3/2</sup> Rrjeshti i dytë i kategorisë 3 të të ardhurave i referohet nivelit minimal të të ardhurave të familjeve të përcaktuara në nenin 24, pika 2, shkronja “a” dhe “b” të ligjit nr.9232, datë 13.05.2004 për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar).

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimeve Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**